



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 98, Datë 09/10/2013

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e znj. [Emri i personit] me Nr. Regjistri 32, datë 10.07.2013, kundër z. [Emri i personit], Drejtor i Spitalit Rajonal Vlorë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**KONSTATOI:**

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ankesa e paraqitur nga ankuesja, znj. [Emri i personit] është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Sipas shpjegimeve të dhëna, znj. [Emri i personit] deklaroi se: "Kam 13 vjet që punoj si laborante pranë Spitalit të qytetit të Vlorës. Me shkresën 1380, datë 06.05.2013 njoftohem nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, pasi nuk kam arsimin e mjaftueshëm për të kryer detyrën si laborante. Me shkresën nr. 1539, datë 31.05.2013 njoftohem nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me arsyen se nuk jam paraqitur në vendin e punës dhe mospërputhje të arsimit që kërkon vendi i punës. Gjatë periudhës që pretendohet se nuk jam paraqitur në vendin e punës, unë kam qenë me leje të zakonshme. Që nga periudha 27.11.2012 deri më 13.05.2013 kam qenë me raport mjekësor nga QSUT Tiranë dhe Komisioni Mjeko-Ligjor Vlorë. Nga data 13.05.2013 deri më 13.06.2013 kam qenë me leje të zakonshme, dhe më datë 07.06.2013, KMCAP Vlorë me përcaktoi si invalide të pjesshme e aftë të punoja 8 orë punë të përshtatshme. Në dallim me punonjësit e tjerë të spitalit, gjatë kohës që kam qenë sëmurë në spitalin Tiranë, nuk më është dhënë dhe ndihma ekonomike nga fondi i veçantë, që jepet në rastet kur punonjësit janë me sëmundje të rëndë".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të rikthehet në vendin e punës sipas përcaktimit të raportit të KMCAP.

Ankesa e znj. ... është mbështetur dhe nga Shoqata e Invalidëve të Punës, dega Vlorë, e cila me shkresën nr.97, datë 24.07.2013 ka informuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me ankesën e znj. ...

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Gjendja shëndetësore, është shkak për të cilin ligji ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me gjendjen shëndetësore.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Më datën 22.07.2013, me shkresën Nr. 392/1 Prot, është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Spitalin Rajonal Vlorë në lidhje me ankesën për pretendim për diskriminim të znj. ...
- Më datën 22.07.2013, me shkresën nr. 392/2 Prot, është kërkuar informacion shtesë nga subjekti ankues në lidhje me ankesën e bërë.

Me shkresën Nr. 2040, datë 30.07.2013 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Spitali Rajonal Vlorë, përgjigjet se:

"Bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" neni 6, pika 1, institucioni ynë nuk mund të nxjerre asnjë informacion pa qenë të autorizuar nga punonjësja".

- Më datë 07.08.2013 nxirret Urdhri Nr. 67, "Për kryerjen e inspektimit në Spitalin Rajonal Vlorë",
- Me shkresën Nr. 433/1 Prot, datë 07.08.2013 njoftohet subjekti Spitali Rajonal Vlorë për kryerjen e inspektimit me datë 15.08.2013.

Objekti i këtij inspektimi ishte sigurimi i informacionit mbi:

- Strukturën e Spitalit Rajonal Vlorë.
- Rregulloren e brendshme të funksionimit të Spitalit Rajonal Vlorë.

- Procedurën e ndjekur për pushimin nga puna të znj. ... kopje të plotë të dosjes së kësaj punonjëse si dhe kopje të kontratës së punës.
- Informacion të punonjësve të trajtuar me shpërblim nga fondi i veçantë për periudhën Shkurt 2011 deri më 31.05.2013.
- Punonjësit që janë pushuar nga puna për mospërputhje të kualifikimeve me kërkesat e vendit të punës që nga periudha Shkurt 2011 deri më 31.05.2013, nëse ka.
- Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë për ndjekjen e kualifikimeve të detyruara në zbatim të Urdhrit 46, datë 11.02.2011 "Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë", neni 9, pika 2, paragrafi i II.

Me datë 15.08.2013, ora 10.00, u realizua inspektimi pranë drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë. Nga ana e spitalit ishin të pranishëm znj. ... me detyrë juriste, z. ... me detyrë Shef i Zyrës së Financës deri më datë 12.04.2013 dhe znj. ... me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Gjatë inspektimit znj. ... deklaroi se znj. ... nuk ka paraqitur kërkesë për tu shpërblyer nga fondi i veçantë i spitalit për arsye shëndetësore. Z. ... i pyetur në lidhje me procedurën për përdorimin e fondit të veçantë, deklaroi se për vitet 2011, 2012 deri më sot në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Vlorë nuk është dhënë asnjë shpërblim nga fondi i veçantë për raste sëmundjesh apo ndërhyrje kirurgjikale. Gjatë këtij inspektimi znj. ... deklaroi se znj. ... ka bërë kërkesë verbale për shfrytëzimin e pushimeve vjetore, e cila po në mënyrë verbale nuk i është miratuar nga Drejtori i Spitalit për arsye të ngarkesës në punë në laborator. Në zyrën e burimeve njerëzore nuk ka një kërkesë me shkrim nga ana e znj. Rrokaj në të cilën kërkon lejen e zakonshme.

### **Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:**

Në lidhje me kërkesën e znj. ... për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i veçantë, Komisioneri vlerëson se përdorimi i fondit të veçantë rregullohet nëpërmjet Vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" i ndryshuar. Në nenin 7 të këtij vendimi shkruhet: "Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë përfshihen pagesat për rastet e: - sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje kirurgjikale apo një trajtim mjekësor i gjatë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 50000 leke për çdo rast".

Referuar proces verbalit të inspektimit të mbajtur më datë 15.08.2013, në të cilin z. ... me detyrë Shef i Zyrës së Financës, deklaroi se për vitin 2011, 2012 dhe deri më sot nuk është dhënë asnjë shpërblim nga fondi i veçantë për raste sëmundjesh apo ndërhyrjesh kirurgjikale, Komisioneri vlerëson se nuk kemi të bëjmë me trajtim të veçantë të znj. Rrokaj or ngelet në kompetencën e drejtuesit të institucionit përdorimi i këtij fondi.

Subjekti ankues, që nga data 07.06.2001, ka punuar si laborante pranë spitalit të qytetit të Vlorës, dhe pas një periudhe katër mujore është transferuar në Poliklinikën e qytetit Vlorë, duke vazhduar të njëjtën detyrë pa ndërprerje deri në vitin 2013, vërtetuar kjo nëpërmjet Librezës së Punës me Nr. të regjistrit themeltar: 1051 Sp. 125/7.

7.07.2001 deri më datë 07.10.2001, znj.Rrokaj ka kryer kursin e kualifikimit si pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", e vërtetuar kjo me "Vërtetim e të Shefit të Shërbimit të Laboratorit Biokimik-Klinik të QSUT".

11.2012-13.05.2013 znj.

paguar me raport paaftësie nga Instituti i Spitalit Vlorë, vërtetuar kjo me "Vërtetim nr. 1328, datë 14.06.2013". Me Vërtetimin Komisioni Miekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAp) pranë Spitalit Vlorë, caktuar se znj. [redacted] plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të lartës 13.05.2013 deri me datë 30.04.2014, dhe duhet të kryejë 8 orë punë të

me Urdhrin e Brendshëm 1380, Drejtori i Spitalit Vlorë ka urdhëruar ndërprerjen me Urdhrin nr. 1380, datë 07.05.2013 të znj. [redacted] pasi nuk ka arsimin e mjaftueshëm për të

anulimin e urdhrin të brendshëm nr. 1380, datë 06.05.2013 për njoftimin e [redacted] shkresën nr 1539, datë 31.05.2013, Drejtori i Spitalit Vlorë ka urdhëruar lirimin nga detyra të znj.Rrokaj për arsye të mosparaqitjes në vendin e

që kërkon vendi i punës me arsimin përkatës të znj.Rrokaj. [redacted] 31.05.2013 e deri më datë 31.05.2013 për arsye të pajustificuar, si dhe për

është në kundërshtim me Urdhrin nr.306, datë 04.07.2012 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Civile, i cili nuk ka plotësuar arsimin e lartë infermjeror", 2. "Nëse për [redacted] fundit, ka pasur raste të largimit nga puna, të bëhet rikthimi i menjëhershëm [redacted] nave të larguar".

13 për ndërprerje të marrëdhënieve financiare është nxjerrë kur znj.Rrokaj nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.05.2004 të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 147, pika 1, "Punëmarrësi kryen [redacted] në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi ose [redacted] pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose [redacted] periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të

nga ana e Drejtorit të Spitalit Vlorë ka pasur një tendence për [redacted] ve të punës me znj. [redacted] ai luke lëshuar dy herë urdhër për [redacted] ve të punës për shkak të mospasjes së arsimit përkatës. Bazuar në [redacted] dhe Funkcionimin e Spitalit, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë [redacted] 10, Detyrat dhe Kompetencat e Drejtorit të Spitalit, pika 16, [redacted] kimin dhe specializimin e kuadrit të lartë dhe të mesëm dhe ndjek [redacted] sonale të znj [redacted] në dispozicion nga Spitali Vlorë më datë [redacted] ent, që vërteton se drejtoria e këtij spitali i ka propozuar apo sugjeruar [redacted] meve për rritjen e saj profesionale apo për të plotësuar kriteret për [redacted] këtë dosje nuk ka asnjë dokument, që vërteton se nga ana e drejtuesve [redacted] drejtje për punën apo aftësitë profesionale të znj.Rrokaj.

Nga periudha 07.07.2001 deri më datë 07.10.2001, znj. [ ] ka kryer kursin e kualifikimit si laborante kimiste pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", e vërtetuar kjo me "Vërtetim e datës 07.10.2001 të Shefit të Shërbimit të Laboratorit Biokimik-Klinik të QSUT".

Nga periudha 27.11.2012-13.05.2013 znj. [ ] është paguar me raport paaftësie nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë, vërtetuar kjo me "Vërtetim nr. 1328, datë 14.06.2013". Me Vërtetimin nr. 380, datë 07.06.2013, Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA) pranë DRSSH Vlorë, ka caktuar se znj. [ ] plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të pjesëshëm prej datës 13.05.2013 deri me datë 30.04.2014, dhe duhet të kryejë 8 orë punë të përshtatshme.

Më datë 06.05.2013 me Urdhrin e Brendshëm 1380, Drejtori i Spitalit Vlorë ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare më datë 07.05.2013 të znj. [ ] si nuk ka arsimin e mjaftueshëm për të kryer detyrën si laborante. Po në datë 06.05.2013 Drejtori i Spitalit Vlorë me Urdhrin e Brendshëm 1380/1 ka urdhëruar anulimin e urdhrit të brendshëm nr. 1380, datë 06.05.2013 për njoftimin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për znj. Rrokaj. Me shkresën nr 1539, datë 31.05.2013, Drejtori i Spitalit Vlorë ka urdhëruar lirim nga detyra të znj. Rrokaj për arsye të mosparaqitjes në vendin e punës që nga data 13.05.2013 e deri më datë 31.05.2013 për arsye të pajustificuar, si dhe për mospërputhje të arsimit që kërkon vendi i punës me arsimin përkatës të znj. [ ]

Shkarkimi i znj. [ ] është në kundërshtim me Urdhrin nr.306, datë 04.07.2012 të Ministrit të Shëndetësisë "Për personelin mjekësor infermier që nuk ka plotësuar arsimin e lartë", në të cilin urdhërohet: 1. "Të mos bëhet asnjë largim nga puna i personelit mjekësor dhe laborant, që punon në institucionet shëndetësore publike, i cili nuk ka plotësuar arsimin e lartë infermieror", 2. "Nëse për këtë arsye, në dy muajt e fundit, ka pasur raste të largimit nga puna, të bëhet rikthimi i menjëhershëm në vendin e punës, i personave të larguar".

Urdhri 1380, datë 06.05.2013 për ndërprerje të marrëdhënieve financiare është nxjerrë kur znj. Rrokaj ka qenë me raport paaftësie nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 147, pika 1, "Punëmarrësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi kryen shërbimin ushtarak, përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëmarrësi".

Sa më sipër konstatohet se nga ana e Drejtorit të Spitalit Vlorë ka pasur një tendencë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me znj. [ ] ke lëshuar dy herë urdhër për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të mospasjes së arsimit përkatës. Bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Spitalit, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë më datë 06.01.1998, në nenin 10, Detyrat dhe Kompetencat e Drejtorit të Spitalit, pika 16, shkruhet: "Vendos për kualifikimin dhe specializimin e kuadrit të lartë dhe të mesëm dhe ndjek zbatimin e tij". Në dosjen personale të znj. [ ] në dispozicion nga Spitali Vlorë më datë 15.08.2013 nuk ka asnjë dokument, që vërteton se drejtorja e këtij spitali i ka propozuar apo sugjeruar znj. [ ] ndjekjen e kualifikimeve për rritjen e saj profesionale apo për të plotësuar kriteret për punonjës laborator. Po ashtu në këtë dosje nuk ka asnjë dokument, që vërteton se nga ana e drejtuesve të këtij institucioni të ketë pasur vërejtje për punën apo aftësitë profesionale të znj. Rrokaj.

Veprimet e paligjshme të Drejtorit të Spitalit Rajonal Vlorë janë konstatuar dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit i cili me shkresën Nr. K1/112-6, datë 09.09.2013 ka rekomanduar revokimin e akteve administrative të urdhrave të brendshëm nr. 1380 datë 06.05.2013 dhe nr.1539 datë 31.05.2013, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm dhe rikthimin e palës, shtetases Tiftiri Rrokaj me të drejtat dhe detyrimet në marrëdhënien e mëparshme të punësimit.

Nga periudha 27.11.2012-13.05.2013 znj. \_\_\_\_\_ shtë paguar me raport paaftësie nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë, vërtetuar kjo me “Vërtetim nr. 1328, datë 14.06.2013”. Me Vërtetimin nr. 380, datë 07.06.2013, Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA) pranë DRSSH Vlorë, ka caktuar se znj. Tiftiri Rrokaj plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të pjesshëm prej datës 13.05.2013 deri me datë 30.04.2014, dhe duhet të kryejë 8 orë punë të përshtatshme.

**Bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë neni 92, pika 3 shkruhet: “.....Periudha e paaftësisë së përkohshme në punë, konsiderohet si kohë pune”, pra siç shikohet znj.Rrokaj kishte të drejtë që të përfitonte pushimet vjetore të paguara.**

Referuar Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Spitalit, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë më datë 06.01.1998, Kreut VII, neni 38, pika 4, është detyrë e Përgjegjës të Poliklinikës që: “Organizon, drejton dhe kontrollon punën e specialistëve të k/infermieres dhe infermierëve të poliklinikës”, vërejmë se organizimi i punës në këtë repart është përgjegjësi e tij, kështu dhe planifikimi i ngarkesës në punë në repartin e laboratorit hyn në detyrat dhe kompetencën e përgjegjës të Poliklinikës.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar vërejmë se ankuesja ka kërkuar që të shfrytëzojë lejen vjetore nga data 13.05.2013 deri më datë 13.06.2013. Kjo kërkesë është firmosur nga Shefi i Shërbimit, znj.Valbona Hibro dhe Kryeinfermierja znj. \_\_\_\_\_. Znj. \_\_\_\_\_ shkresën nr. 1376 datë 06.05.2013 ka qenë e emëruar në detyrën e shefes së shërbimit të poliklinikës, ndërsa znj. Shkurtaj deri më datë 20.05.2013 ka qenë në detyrën kryeinfermiere e poliklinikës, vërtetuar kjo me shkresën nr. 1477, datë 20.05.2013, urdhër i brendshëm i Drejtorit të Spitalit Vlorë. Znj. \_\_\_\_\_ gjatë inspektimit të datës 15.08.2013 deklaroi se kërkesa për shfrytëzimin e lejes së zakonshme të znj.Rrokaj është bërë në mënyrë verbale dhe po në mënyrë verbale i është komunikuar mosmiratimi i lejes nga ana e Drejtorit të Spitalit për arsye të ngarkesës në punë në laborator.

Referuar strukturës analitike të Spitalit Rajonal Vlorë, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë me shkresën nr. 2291, datë 07.05.2013, në shërbimin e Poliklinikës së Specialiteteve janë të punësuar 10 punonjës laborantë. Nga ana e spitalit Vlorë nuk u paraqit asnjë dokument/raport apo justifikim që të vërtetonte se mungesa e punonjësës për shkak të shfrytëzimit të pushimeve vjetore do të kishte cenuar vijueshmërinë e shërbimeve në këtë laborator.

Nga ana e spitalit Vlorë nuk u paraqit asnjë dokument që të vërtetonte se procedura për miratimin e pushimeve vjetore të znj.I \_\_\_\_\_ që bëhesh nga ana e Drejtorit të Spitalit, prandaj konsiderojmë se mosmiratimi verbalisht dhe pa asnjë argumentim i lejes vjetore nga ana e Drejtorit të Spitalit Rajonal Vlorë është tendencioz dhe diskriminues.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar në nenin 3/1 se: **çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij**

ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi, përbën diskriminim.

Për më tepër ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndalon diskriminimi e personave në lidhje me të drejtën e tyre për punësim. Kështu në nenin 12, pika 1, përcaktohet se ndalohet diskriminimi për shkak të gjendjes shëndetësore dhe që ka lidhje me: c) *“trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

#### PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të znj. Tiftiri Rrokaj, nga ana e z. ...  
Drejtor i Spitalit Rajonal Vlorë, për shkak të gjendjes shëndetësore në fushën e punësimit.
2. Rekomandon kthimin në vendin e punës të znj. Tiftiri Rrokaj.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtori i Spitalit Rajonal Vlorë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kujtojmë se bazuar në nenin 35 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” çdo person mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e tij por kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

